



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:170247

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05812474

KA.nr.587/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Trosha” SH.P.K., me NUI: 810832891, me seli në Prishtinë adresa rruga “Rexhep Luci”, p.n, me pronar K.R., kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Ibrahim Tërshnjaku udhëheqës i Inspektoratit Sanitar të Kosovës, për shkak të anulimit të vendimin AUV nr.008634 i datës 14.10.2020 dhe Vendimi AUV.ref.04/2-2247/2020 i datës 12.11.2020 i organit të shkallës së dytë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor më datë 14.05.2024, në mungesë të përfaqësuesit të palës paditëse, ndërsa në prani të përfaqësuesit të palës së paditur, më datë 30.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET në tërësi** kërkesëpadia e paditësit “TROSHA” SH.P.K., me NUI: 810832891, me seli në Prishtinë kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë, me çka ka kërkuar të anulohet vendimi AUV nr.008634 i datës 14.10.2020 dhe Vendimi AUV.ref.04/2-2247/2020 i datës 12.11.2020 i organit të shkallës së dytë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, **si e bazuar.**
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 04.12.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative “Trosha” SH.P.K., me seli në Prishtinë ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.2083/2020, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë, për shkak të anulimit të vendimin AUV nr.008634 i datës 14.10.2020 dhe Vendimi AUV.ref.04/2-2247/2020 i datës 12.11.2020 të organit të shkallës së dytë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, me propozim që Gjykata të aprovoj si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, të anulohet vendimi i Inspektoratit Sanitar AUV nr. 008634 i datës 14.10.2020 dhe Vendimi i Organit të Shkallës së Dytë-Vendimi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë AUV .Ref..04/2-2247/2020 i datës 12.11.2020, si i pa bazuar. Me propozim që të obligohet e paditura që brenda afatit prej 30 ditësh të nxjerr vendim tjetër dhe çështja të rikthehet në gjendjen e cila ishte para nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar dhe paditësit t’ia kompensoj të gjitha shpenzimet e procedurës.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr.587/22.
3. Gjykata më datë 14.05.2024, mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik, në mungesë të përfaqësuesit të palës paditëse, konform nenit 41 të LKA-së, paditësi ftesën për në seancë e pranuar më date 17.04.2024, ndërsa me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës së paditur Ibrahim Tërshnjaku udhëheqës i Inspektoratit Sanitar të Kosovës.

Pretendimet e paditës

4. Përfaqësuesit e paditësit në padi ka deklaruar se Inspektori Sanitar i Inspektoratit të Republikës së Kosovës më datë 14.10.2020 në ora 21.15 i ka shqiptuar gjobën nr. 008634, në shumën prej 500 euro, me arsyetim se gjatë kontrollit zyrtar kanë gjeti se është vepruar në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së datës 25.09.2020 , nr. 01/32, pika 4 nën-pika 4.3 dhe nenit 11 par. 1.5 të Ligjit nr. 07/L/006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë, me arsyetim” nuk është respektuar distancë prej 2 m, në mes të tavolinave, si dhe masat

e përgjithshme për mbrojtjen nga Covid 19”. Pretendon se nuk ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë, gjithmonë i ka respektuar me përpikëri të gjitha masat anti Covid/19. Në momentin kur kanë hyrë inspektorët në lokal nuk ka pasur asnjë person, andaj në një situatë të tillë nuk ka pasur se si të aplikohen masat e distancës.

5. Përfundimisht ka pretenduar se vendimet e atakuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave nga neni 84par.2 dhe neni 85 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse fare nuk janë përfshirë përmbledhjet e konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e grumbulluara, sepse nuk përmbajnë deklaram të bazës ligjore në të cilën bazohet akti. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit të anulohet vendimi i Inspektoratit Sanitar AUV nr. 008634 i datës 14.10.2020 dhe Vendimi i Organit të Shkallës së Dytë-Vendimi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë AUV .Ref..04/2-2247/2020 i datës 12.11.2020, si i pa bazuar. Ka propozuar që të obligohet e paditura që brenda afatit prej 30 ditësh të nxjerr vendim tjetër dhe çështja të rikthehet në gjendjen e cila ishte para nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar dhe paditësit t’ia kompensoj të gjitha shpenzimet e procedurës.

Kundërshtimet e të paditurës

6. Përfaqësuesi sipas autorizimit i palës së paditur në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi, në deklaramet e dhëna në seancë të shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se më datë 14.10.2020 në ora 21:15 inspektorët Sanitar paditësit i kanë shqiptuar gjobë në shumën prej 500 euro, pasi që gjatë kontrollit zyrtar rreth zbatimit të masave anti-covid 2019 kanë konstatuar se Trosha SH.P.K., ka vepruar në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 25.09.2020 nr. 01/32 pika 4 nënpika 4.3 dhe nenit 11 par1.5 të Ligjit 07/L006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid/19, me arsyetim se nuk është respektuar distanca në mes të tavolinave prej 2m, si dhe masat e përgjithshme për mbrojtjen nga Covid 19, andaj komisioni bazuar në nenin 24.4 të Ligjit nr.07/L-006 për Parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, shqiptoi gjobën konform dispozitave ligjore përkatëse. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit “Trosha” SH.P.K., dhe të lë në fuqi Vendimin AUV Ref 04/2-2247/2020 të datës12.11.2020 si të pa bazuar në ligj.

Provat e administruara

7. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Fletëpërmbajtje për kundërvajtje nga ISK me nr. 008634. Ankesa e paditësit , Vendimi AUV.Ref:04/2-2247 i datës 12.11.2020.
8. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaramet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar.
9. Nga fletë përmbajtje për kundërvajtje nga Inspektorati Sanitar i Kosovës me nr. 008634, Inspektorati Sanitar i Kosovës më datë 14.05.20220 në ora 21.15 minuta i ka shqiptuar gjobë në shumë prej 500 euro paditësit “Trosha” SH.P.K, me konstatim se subjekti nuk ka respektuar vendimin e qeveris dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjithëse, subjektiviteti nuk ka pasur distancë të mjaftueshme në mes të tavolinave, në hapësira të brendshme tavolinat ishin më pak se 1 m. Paditësi ka parashtruar ankesë ndaj gjobës së shqiptuar në vlerë prej 500 euro nga Inspektorët Sanitar të AUV-së.
10. Komisioni për shqyrtimin e ankesave në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (tutje AUV), me Vendimi AUV.Ref:04/2-2247 të datës 12.11.2020, ka refuzuar ankesën e paditësit me nr. 6150/1 e datës 19.10.2020 si të pabazuar me arsyetim se, më datë 14.10.2020 në ora 21:15 Inspektorët Sanitar paditësit i kanë shqiptuar gjobë në shumën prej 500 euro, pasi që gjatë kontrollit zyrtar rreth zbatimit të masave anti-covid 2019 është konstatuar se Trosha SH.P.K., ka vepruar në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 25.09.2020 nr. 01/32 pika 4 nënpika 4.3 dhe nenit 11 par1.5 të Ligjit 07/L006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid/19 se nuk është respektuar distanca në mes të tavolinave prej **2m**, si dhe masat e përgjithshme për mbrojtjen nga Covid 19 dhe ka vlerësuar se gjoba e është shqiptuar konform dispozitave ligjore përkatësisht bazuar në vendimin qeveritar të datës 25.09.2020 Nr. 01/32 pika 4 nënpika 4.3 bazuar në Ligjin nr. 07/l-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid 2019.

Vlerësimi i gjykatës

11. Gjykata vlerësoj se padia është parashtruar, **sipas Nenit 13** paragrafi 1, tw LKA ku përcaktohet se *Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën, administrative në shkallë të dytë.*
12. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.
13. Vendimi i Inspektoratit Sanitar AUV nr. 008634 i datës 14.10.2020 dhe Vendimi i Organit të Shkallës së Dytë-Vendimi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë AUV .Ref..04/2-2247/2020 i datës 12.11.2020, është në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 07/l-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovë, Neni 1 përcakton se “Ky ligj ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19”. Neni 11 paragrafi 1 përcakton se “Masa të përgjithshme për mbrojtjen nga COVID-19 janë” “pika 1.5 mbajtja e distancës”.
14. Ndërsa, distanca ishte përcaktuar prej 2m hapësirë ndërmjet tavolinave është përcaktuar me Vendimin Nr.01/32 i Qeverisë së Republikës së Kosovës pika 4 përcakton se “të gjitha subjektet të cilat ofrojnë shërbime të gastronomisë (restorantet, kafiteritë dhe të ngjashme bazuar në vlerësimin e dhënë nga autoritetet komunale dhe se i plotësojnë kushtet për punë duke respektuar masat mbrojtëse kundër Covid 19”, nën pika 4.3 përcakton se “subjektet që ofrojnë shërbime të gastronomisë mund të punojnë duke respektuar distancën prej 2m hapësirë ndërmjet tavolinave si dhe të mbajnë dezinfektantët për duar në çdo tavolinë të cilat mund të shfrytëzohen nga klientët”.
15. Nga provat e administruara nuk u konstatua me asnjë provë se paditësi kishte respektuar masat mbrojtëse kundër Covid 19, të cilat ishin në fuqi dhe të zbatueshme në kohën e marrjes së vendimit të kundërshtuar. Prandaj, vlerëson se nga provat e administruara nuk është vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga ajo që i padituri e ka vërtetuar në procedurë administrative. Sipas Nenit 24 par.4 përcakton se “Personi juridik i cili nuk e zbaton

vendimin e Organit Kompetent për krijimin e kushteve dhe mbajtjen e distancës së përcaktuar në hapësirat në të cilat janë përgjegjës dënohen me gjobë prej pesëqind (500) euro, ndërsa personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë prej dyqind (200) euro”.

16. Prandaj, vlerëson se e paditura Komisioni për shqyrtimin e ankesave në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (tutje AUV), me Vendimi AUV.Ref:04/2-2247 të datës 12.11.2020, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike në procedurë administrative si dhe ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzoj ankesën e paditësit si të pabazuar.
17. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.587/22, datë 30.05.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.